

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI



Nr. 3968/prot.

12

Pogradec, më 13.08 2024

Lënda: Dërgohet materiali për shqyrtim e miratim.

Znj. Manjola Kamolli, KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

E nderuar zonja Kryetare,

Bashkëngjitur po ju dërgojme projekt vendimin, dhe relacionet shoqëruese , për:

**“PËR RINOVIMIN E KONTRATAVE PËR AMBIENTET DHE OBJEKTET E MARRA
ME QIRA, TË CILAT KANË SHËRBYER SI KOSHTE DHE SHKOLLA NË
BASHKINË POGRADEC ”**

Me respekt

Kryetari

Ilir XHAKOLLI



Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: 2 faqe

Nr. i faqeve A4 të relacionit shoqërues: 9 faqe



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. _____ prot.

Pogradec, më ____ . ____ .2024

PROJEKT-VENDIM

NR _____, DATË ____ . ____ .2024

**“PËR RINOVIMIN E KONTRATAVE PËR AMBIENTET DHE OBJEKTET E MARRA
ME QIRA, TË CILAT KANË SHËRBYER SI KOSHTE DHE SHKOLLA NË
BASHKINË POGRADEC ”**

Në mbështetje të shkronjës "a", shkronjës "c" të pikës 1.2 të nenit 9, në pikën 12 të nenit 23, në shkronjën "b" dhe shkronjën "gj" të nenit 64 të Ligjit Nr.139, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, në Ligjin Nr.10926, datë 08.07.2011, "Per menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, në nenin 801 e vijues të Ligjit Nr. 7850, datë 29.7.1994, "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak Pogradec nr.85, datë 11.08.2023” si dhe mbështetur tek Relacionet shpjeguese të Qendrës Arsimore dhe Kërkesat e Administratorëve të Njësive Administrative përkatëse,

**KËSHILLI I BASHKISË
VENDOSI:**

1. Të rinovohen kontratat e lidhura në vitin 2023 nga Bashkia Pogradec për ambientet e marra me qera në kuadër të funksionimit të tyre si objekte që kanë shërbyer si kopshte dhe çerdhe.
2. Rinovimi i këtyre kontratave të hyjë në fuqi më datë 01.09.2024, që korrespondon me fillimin e Vitit të Ri shkollor 2024-2025 dhe do të zgjasë deri më 01.07.2025.
3. Vlerat e kontratave dhe Kushtet e tjera të tyre mbeten të pandryshuara. Vlerat e qerasë mujore për secilën Njësi Administrative janë si mëposhtë:
 - 3.1 Fshati **Selcë e Poshtme** në *Njësinë Administrative Proptisht*. Ambjenti shërben si shkollë bazuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.85 datë 11.08.2023 me vlerë qeraje 8 000 (tetë mijë) lekë në muaj.

- 3.2 Fshati **Buzaishtë** në *Njësinë Administrative Velçan*. Ambjenti shërben si kopësht dhe si shkollë (arsim fillor), bazuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.85 datë 11.08.2023, me vlerë qeraje 6 000 (gjashtë mijë) lekë në muaj.
- 3.3 Fshati **Buzaishtë** në *Njësinë Administrative Velçan*. Ambjenti shërben si shkollë (arsim fillor), bazuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.85 datë 11.08.2023, me vlerë qeraje 6 000 (gjashtë mijë) lekë në muaj.
- 3.4 Fshati **Stropckë** në *Njësinë Administrative Dardhas*. Ambjenti shërben si kopësht bazuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.85 datë 11.08.2023, me vlerë qeraje 8 000 (tetë mijë) lekë në muaj.
4. Për zbatimin e vendimit, ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe e Prokurimeve Publike, Qendra Arsimore e Bashkisë si dhe administrata e bashkisë Pogradec.
5. Ky vendim hyn në fuqi, 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARE
Manjola KAMOLLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI



Nr. _____ prot.

Pogradec, më _____, 2024

RELACION

“PËR RINOVIMIN E KONTRATAVE PËR AMBIENTET DHE OBJEKTET E MARRA ME QIRA, TË CILAT KANË SHËRBYER SI KOSHTE DHE SHKOLLA NË BASHKINË POGRADEC”:

1. Fshati **Selcë e Poshtme** në *Njësinë Administrative Proptisht*. Ambienti shërben si shkollë bazuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 83 datë 19.07.2022

Vlera e qerasë 8.000 lekë në muaj.

2. Fshati **Buzaishtë** në *Njësinë Administrative Velçan*. Ambienti shërben si kopësht bazuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 83 datë 19.07.2022.

Vlera e qerasë 6.000 lekë në muaj.

3. Fshati **Buzaishtë** në *Njësinë Administrative Velçan*. Ambienti shërben si shkollë bazuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 101 datë 20.09.2022.

Vlera e qerasë 6.000 lekë në muaj.

4. Fshati **Stropckë** në *Njësinë Administrative Dardhas*. Ambienti shërben si kopësht bazuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 83 datë 19.07.2022.

Vlera e qerasë 8.000 lekë në muaj.

Të dhënat e Projekt-Vendimit:

Konceptoi: Ledio Shkullaku

Pranoi: Majlinda Çuni

Miratoi: Anxhela Andoni

Konfirmoi: Dritan Babasuli

KRYETAR

Ilir XHAKOLLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI



Nr. _____ prot.

Pogradec, më ____ . ____ .2024

RELACION

MBI PROJEKT-VENDIMIN:

``PËR RINOVIMIN E KONTRATAVE PËR AMBIENTET DHE OBJKTET E MARRA ME QIRA, TË CILAT KANË SHËRBYER SI KOSHTE DHE SHKOLLA NË BASHKINË POGRADEC``

Të nderuar këshilltarë!

Projekt-vendimi që po ju paraqesim vjen si një detyrim ligjor që ka Këshilli i Bashkisë Pogradec për të miratuar këtë projekt-vendim për mbrojtjen dhe garantimin e interesit publik.

Fëmijët në fshatin Buzaishtë të cilët frekuentojnë kopshtin e kanë të pamundur të shkojnë në ambientet e tij pasi në këtë fshat procesi mësimor zhvillohej në godinën e kishës në fshat, e cila tashmë është mbyllur. Në këto kushte, duke mos patur një ambient publik të përshtatshëm që fëmijët të zhvillojnë procesin mësimor në këtë fshat, nevojitet një ambient privat për mbarëvajtjen e procesit mësimor për vitin shkollor 2024-2025. Ky kopsht do të frekuentohet nga 12 fëmijë.

Duke patur parasysh se nga ana e edukatores së kopshtit dhe Administratorit të Njesisë Administrative Velçan, na është bërë i ditur ky problem si dhe në interesin më të lartë të fëmijëve që mbeten pa arsim dhe në përgjigje ndaj kërkesave të vazhdueshme të prindërve, kemi menduar si të vetmen alternativë për një zgjidhje të përkohshme marrjen me qira për periudhën Shtator-Korrik, një ambient për vazhdimësinë e procesit mësimor.

Duke ju falenderuar për mbështetjen tuaj, ju ftojme ta votoni propozimin për miratimin e projekt-vendimit ``Për rinovimin e kontratave për ambientet dhe objektet e marra me qira, të cilat kanë shërbyer si kopshte dhe shkolla në Bashkinë Pogradec``.

Ftojme Këshilltarët të votojnë këtë Projekt-Vendim

Faleminderit!

Të dhënat e Projekt-Vendimit:

Konceptoi: Ledio Shkullaku

Pranoi: Majlinda Çuni


Miratoi: Anxhela Andoni

Konfirmoi: Dritan Babasuli



KRYETAR

Ilir XHAKOLLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. _____ prot.

Pogradec, më _____.____.2024

RELACION

MBI PROJEKT-VENDIMIN:

``PËR RINOVIMIN E KONTRATAVE PËR AMBIENTET DHE OBJKTET E MARRA ME QIRA, TË CILAT KANË SHËRBYER SI KOSHTE DHE SHKOLLA NË BASHKINË POGRADEC``

Të nderuar këshilltarë!

Projekt-vendimi që po ju paraqesim vjen si një detyrim ligjor që ka Këshilli i Bashkisë Pogradec për të miratuar këtë projekt-vendim për mbrojtjen dhe garantimin e interesit publik.

Fëmijët në fshatin Selcë e Poshtme të cilët frekuentojnë shkollën e kanë të pamundur të shkojnë në ambientet e saj pasi shkolla në këtë fshat është totalisht jashtë standarteve dhe nuk mund të kryhet procesi mësimor. Në këto kushte, duke mos patur një ambient publik të përshtatshëm që fëmijët të zhvillojnë procesin mësimor në këtë fshat, nevojitet një ambient privat për mbarëvajtjen e procesit mësimor për vitin shkollor 2024-2025. Kjo shkollë do të frekuentohet nga 10 fëmijë përkatësisht nga klasa e parë deri në klasën e katërt.

Duke patur parasysh se nga ana e stafit mësimor dhe Administratorit të Njesisë Administrative Proptisht, na është bërë i ditur ky problem si dhe në interesin më të lartë të fëmijëve që mbeten pa arsim dhe në përgjigje ndaj kërkesave të vazhdueshme të prindërve, kemi menduar si të vetmen alternativë për një zgjidhje të përkohshme marrjen me qira për periudhën Shtator-Korrik, një ambient për vazhdimësinë e procesit mësimor.

Duke ju falenderuar për mbështetjen tuaj, ju ftojme ta votoni propozimin për miratimin e projekt-vendimit ``Për rinovimin e kontratave për ambientet dhe objektet e marra me qira, të cilat kanë shërbyer si kopshte dhe shkolla në Bashkinë Pogradec``.

Ftojme Këshilltarët të votojnë këtë Projekt-Vendim

Faleminderit!

Të dhënat e Projekt-Vendimit:

Konceptoi: Ledio Shkullaku

Pranoi: Majlinda Çuni

Miratoi: Anxhela Andoni

Konfirmoi: Dritan Babasuli



KRYETAR

Ilir XHAKOLLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI



Nr. _____ prot.

Pogradec, më ____ . ____ .2024

RELACION

MBI PROJEKT-VENDIMIN:

``PËR RINOVIMIN E KONTRATAVE PËR AMBIENTET DHE OBJKTET E MARRA ME QIRA, TË CILAT KANË SHËRBYER SI KOSHTE DHE SHKOLLA NË BASHKINË POGRADEC``

Të nderuar këshilltarë!

Projekt-vendimi që po ju paraqesim vjen si një detyrim ligjor që ka Këshilli i Bashkisë Pogradec për të miratuar këtë projekt-vendim për mbrojtjen dhe garantimin e interesit publik.

Fëmijët në fshatin Buzaishtë të cilët frekuentojnë shkollën (fillore) e kanë të pamundur të shkojnë në ambientet e saj pasi në këtë fshat procesi mësimor zhvillohej në një godinë private që nuk është më në dispozicion. Në këto kushte, duke mos patur një ambient publik të përshtatshëm që fëmijët të zhvillojnë procesin mësimor në këtë fshat, nevojitet një ambient tjetër privat për vitin shkollor 2024-2025. Kjo shkollë do të frekuentohet nga 9 fëmijë duke përfshirë klasën e parë deri tek klasa e pestë.

Duke patur parasysh se nga ana e edukatores së kopshtit dhe Administratorit të Njesisë Administrative Velçan, na është bërë i ditur ky problem si edhe në interesin më të lartë të fëmijëve që mbeten pa arsim dhe në përgjigje ndaj kërkesave të vazhdueshme të prindërve, kemi menduar si të vetmen alternativë për një zgjidhje të përkohshme marrjen me qira të një ambienti privat duke siguruar vazhdimësinë e procesit mësimor.

Duke ju falenderuar për mbështetjen tuaj, ju ftojme ta votoni propozimin për miratimin e projekt-vendimit ``Për rinovimin e kontratave për ambientet dhe objektet e marra me qira, të cilat kanë shërbyer si kopshte dhe shkolla në Bashkinë Pogradec``.

Ftojme Këshilltarët të votojnë këtë Projekt-Vendim

Faleminderit!

Të dhënat e Projekt-Vendimit:

Konceptoi: Ledio Shkullaku

Pranoi: Majlinda Çuni

Miratoi: Anxhela Andoni

Konfirmoi: Dritan Babasuli



KRYETAR

Ilir XHAKOLLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI



Nr. _____ prot.

Pogradec, më ____ . ____ . 2024

RELACION

MBI PROJEKT-VENDIMIN:

``PËR RINOVIMIN E KONTRATAVE PËR AMBIENTET DHE OBJEKTET E MARRA ME QIRA, TË CILAT KANË SHËRBYER SI KOSHTE DHE SHKOLLA NË BASHKINË POGRADEC``

Të nderuar këshilltarë!

Projekt-vendimi që po ju paraqesim vjen si një detyrim ligjor që ka Këshilli i Bashkisë Pogradec për të miratuar këtë projekt-vendim për mbrojtjen dhe garantimin e interesit publik.

Fëmijët në fshatin Stropckë të cilët frekuentojnë kopshtin e kanë të pamundur të shkojnë në ambientet e tij pasi kopshti në këtë fshat prej shumë vitesh është totalisht i rrënuar dhe nuk mund të kryhet procesi mësimor. Në këto kushte, duke mos patur një ambient publik të përshtatshëm që fëmijët të zhvillojnë procesin mësimor në këtë fshat, nevojitet një ambient privat për mbarëvajtjen e procesit mësimor për vitin shkollor 2024-2025. Ky kopsht do të frekuentohet nga 6 fëmijë

Duke patur parasysh se nga ana e edukatores së kopshtit dhe Administratorit të Njesisë Administrative Dardhas, na është bërë i ditur ky problem si dhe në interesin më të lartë të fëmijëve që mbeten pa arsim dhe në përgjigje ndaj kërkesave të vazhdueshme të prindërve, kemi menduar si të vetmen alternativë për një zgjidhje të përkohshme marrjen me qira për periudhën Shtator-Korrik, një ambient për vazhdimësinë e procesit mësimor.

Duke ju falenderuar për mbështetjen tuaj, ju ftojme ta votoni propozimin për miratimin e projekt-vendimit ``Për rinovimin e kontratave për ambientet dhe objektet e marra me qira, të cilat kanë shërbyer si kopshte dhe shkolla në Bashkinë Pogradec``.

Ftojme Këshilltarët të votojnë këtë Projekt-Vendim

Faleminderit!

Të dhënat e Projekt-Vendimit:

Konceptoi: Ledio Shkullaku

Pranoi: Majlinda Çuni

Miratoi: Anxhela Andoni

Konfirmoi: Dritan Babasuli



KRYETAR

Ilir XHAKOLLI